



01 Nr. 521/25 D. 03.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

29.07.2025

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 lidhur me nenin 18 paragrafi 1.9 i Rregullores Komunale nr. 001-011-201 datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643 të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-030 nr. 114639 datë 25.08.2025 të Imran Duraki, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-030 nr. 114639 datë 25.08.2025 të Imran Duraki, sportist i Klubit të Pingpongut KVPP, për lejimin e mjeteve për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve rreth pjesëmarrjes në tre turne të pingpongut (në Maqedoni të Veriut, Turqi dhe Podgoricë), që do të mbahen gjatë vitit 2025, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshme të shpenzimeve të pjesëmarrjes, lejohen mjetet financiare në shumën prej 990 € (nëntëqind e nëntëdhjetë euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës – pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe mallra dhe shërbime.
3. Mjetet e lartcekura, si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të alokohen në xhirollogarinë e Inela Salijevic-Duraki (prind i Imran Duraki) .
4. Obligohet Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



➤ Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurës,
- Arkivës së Kryetarit.